



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 08 dhjetor 2016, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-I-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Fikrim Damka, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Enver Hoxhaj, Fitim Sadiku nga MPJ. Valbon Bytyqi, Emine Fazliu dhe Safet Berisha nga ZKA. Fjolla Uka nga KDI.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, i ftuar z. Enver Hoxhaj, ministër;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
4. Të Ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari: Opinioni për PVF e MPJ-së të vitit 2015 është Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ndërlidhet me faktin që: MPJ nuk i ka mbyllur shpenzimet për mallra dhe shërbime të realizuara nga MDK-të në vlerë prej 411,073€. Prej tyre 271,259€ ishin shpenzime të pa aprovuara nga vitet paraprake (shpenzimet e pa aprovuara kanë ndodhur kryesisht si rezultat i gabimeve, kursit të këmbimit, mos regjistrimit të shpenzimeve, shpenzimeve të palejuara me rregullore dhe depozitave të paregjistruara). Pjesa prej 139,814€ ishin shpenzime të paregjistruara të vitit 2015 të cilat ndodhin si rezultat i specifikave që ka MPJ me misione diplomatike. Pasuria e paprekshme (softwerë) në vlerë prej 128,532€ të projektit “Krijimi dhe vendosja e sistemit të vizave” nuk ishte e regjistruar në SIMFK në mungesë të raportit të pranimit. Me këtë e hapi diskutimin.

Bali Muharremaj theksoi se Opinioni për PVF e MPJ-së të vitit 2015 është opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ndërlidhet me faktin që: MPJ nuk i ka mbyllur shpenzimet për mallra dhe shërbime të realizuara nga MDK-të në vlerë prej 411,073€. Prej tyre 271,259€ ishin shpenzime të pa aprovuara nga vitet paraprake (shpenzimet e paaprovuara kanë ndodhur kryesisht si rezultat i gabimeve, kursit të këmbimit, mos regjistrimit të shpenzimeve, shpenzimeve të palejuara me rregullore, dhe depozitave të paregjistruara). Pjesa prej 139,814€ ishin shpenzime të paregjistruara të vitit 2015 të cilat ndodhin si rezultat i specifikave që ka MPJ me misione diplomatike; dhe Pasuria e paprekshme (softwerë) në vlerë prej 128,532€ të projektit “Krijimi dhe vendosja e sistemit të vizave” nuk ishte e regjistruar në SIMFK në mungesë të raportit të pranimit. Çështjet më të rëndësishme nga Raporti i Auditimit të PVF-ve të MPJ-së për vitin 2015.

-Shpenzimet e paaprovuara (të pambyllura) të MDK-ve. MPJ-në, në vazhdimësi nëpër vite po e përcjell një gjendje e shpenzimeve të ndodhura, por të paaprovuara dhe të pa regjistruara. Kjo situatë është nga viti 2008 e deri në 2015, e që si rrjedhojë po ndikon që gjendja e Parasë së Gatshme në SIMFK të jetë më e madhe se sa që në realitet është për shkakun që një pjesë e shpenzimeve të ndodhura nëpër MDK kanë mbetur të pambyllura. Sipas SIMFK-së deri në vitin 2015 nuk janë mbyllur shpenzimet për mallra dhe shërbime të realizuara nga MDK në vlerë prej 411,073€. Prej tyre 271,259€ ishin shpenzime të pa aprovuara nga vitet paraprake, ndërsa pjesa tjetër prej 139,814€ ishin shpenzime të paregjistruara të vitit 2015. Sekretari ka emëruar një zyrtar për barazim i cili ka identifikuar një pjesë të shpenzimeve të pambyllura, dhe të hyrave të cilat kërkojnë një trajtim para se të evidentohen. Diferencat janë konstatuar kryesisht si rezultat i gabimeve, kursit të këmbimit, mos regjistrimit të shpenzimeve të transferimeve, shpenzimeve të palejuara me rregullore, depozitave të paregjistruar etj. Nga gjashtë misionet e trajtuara janë identifikuar këto rezultate, por që nuk janë ende finale: shpenzime të pambyllura 236,875€, të hyra të pa evidentuara 41,970€ dhe diferenca në transferimet e fund vitit 40,000€. Menaxhmenti

i MPJ- së ka mbajtur një takim me zyrtarët e Ministrisë së Financave por ende nuk ishte gjetur një model i trajtimit dhe i regjistrimit të këtyre të dhënave. Po ashtu pyeti? Pse kemi vonesa në regjistrimin e shpenzimeve të kontestuara kur dihet se një vlerë e tyre tanimë është identifikuar? Pse në fund të çdo viti kemi shpenzime të paregjistruara kur dihet që edhe Thesari i lejon MPJ-së regjistrimin deri në fund të janarit?

-Niveli i ulët i rekomandimeve të zbatuara nga viti paraprak. MPJ ka bërë një progres të kufizuar në adresimin e rekomandimeve, pasi që një numër i vogël i rekomandimeve të dhëna janë implementuar, ndërsa shumica e tyre janë ose në proces të adresimit ose nuk janë adresuar. Rekomandimet kyçe të pa adresuara plotësisht ndërlidhen me fushat kryesore, si: shpenzimet e pambyllura nga vitet paraprake, menaxhimi me ushtrues detyre, menaxhimi i dobët i shpenzimeve, aplikimi i prokurimeve me kuotim të çmimeve, dhe raportime mujore jo të plota të obligimeve. Menaxhmenti së bashku me zyrtarët përgjegjës, është duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të adresuar rekomandimet e mbetura. Disa nga pyetjet lidhur me çështjen 2: A ka monitoruar menaxhmenti zbatimin e planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve? Cilat janë faktorët që kanë ndikuar që rekomandimet e vitit të kaluar të mos adresohen?

-Vetëvlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut nuk po adresohen. Pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar nga MPJ ka vërtetuar se shumë prej pyetjeve nuk ishin trajtuar fare. Po ashtu as sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin funksionale. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se MPJ nuk ka identifikuar dhe hartuar ndonjë listë të rreziqeve përfshirë edhe ndonjë plan veprimi për menaxhimin e rreziqeve. Pyetja lidhur me çështjen 3: Pse procesit të vetëvlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut nuk po i kushtohet vëmendje e duhur nga menaxhmenti për të përmirësuar qeverisjen në organizatë? Çështja 4 - Monitorimi i projektit për sistemin e vizave Projekti “Krijimi dhe vendosja e Sistemit të Vizave në Kosovë”, ka filluar në vitin 2013, vlera e marrëveshjes ishte afërsisht 2.2mil€, kjo ishte vazhduar edhe me katër anekset e nënshkruara ku i gjithë projekti pritet të kushtojë 2,607,582€. Qeveria Norvegjeze e ka financuar projektin me 1,768,504€ apo (14.4 mil NOK), kurse MPJ projektin do ta financojë me 839,078€. Deri në fund të vitit 2015 vlera e paguar ishte 2,168,504€. Periudha e finalizimit të projektit është zgjatur deri në fund të muajit maj 2016 me amendamentin e katërt. Projekti nga fillimi kishte pësuar mjaft ndryshime dhe procesi i menaxhimit ishte përcjellë me mjaft mangësi si: Projekti nuk kishte qenë i përfshirë në PIP dhe numri i projektit kishte ndryshuar nëpër vite. Po ashtu edhe pagesat e dy viteve të para ishin realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime, kurse në vitin 2015 pagesa prej 100,000€ ishte realizuar prej kapitaleve, pa qenë e planifikuar për këtë projekt; dhe me marrëveshje nuk ishte definuar qartë formati i monitorimit të projektit nga ana e MPJ-së para se të procesohet çdo pagesë. Raportet e pranura të progresit ishin të përgjithësuara dhe nuk kishte një elaborim të qartë prapa çdo pagese të bërë. Për shumën e borxhit të mbetur prej 439,078€ edhe në ministri ka paqartësi. Pse projekti nuk ishte vendosur në PIP dhe pse buxheti nuk ishte specifikuar për këtë projekt? A është formuar ndonjë Komision monitorues dhe si do të menaxhohet pjesa e obligimeve të mbetura nga ana e MPJ-së?

-Nënvlerësimi i shpenzimeve si rezultat i kursit të këmbimit. Ambasada e Kosovës në Angli pranon mjete financiare nga MPJ të cilat shndërrohen në valutën vendore (£) funta sipas kursit të këmbimit. Pastaj të gjitha shpenzimet e ndodhura raportohen dhe duhet të regjistrohen në euro në SIMFK. Meqenëse kursi i këmbimit mund të ndryshojë, është praktikë e mirë për barazim financiar, që të gjitha shpenzimet e një transferimi të regjistrohen (mbyllen) sipas kursit të këmbimit të transferimit. Gjatë vitit 2015 MPJ ka realizuar nëntë transferime në vlerë prej 283,716€ ose 202,316£. Secili transferim ishte bërë me kurs të ndryshëm të këmbimit. Vlera në funta ishte shpenzuar plotësisht, mirëpo gjatë shndërrimit në euro dhe regjistrimit në SIMFK është aplikuar gjatë tërë vitit një kursi mesatar sipas të cilit ka rezultuar që janë shpenzuar dhe regjistruar në SIMFK 261,938€ apo 21,778€ shpenzime më pak se sa që ishte dashur. Disa nga pyetjet lidhur me çështjen 5: A ka staf profesional nëpër MDK dhe si do të trajtohen shpenzimet e paregjistruara? A ka diferenca edhe në MDK tjera, ku valuta e këmbimit s' është euro? Menaxhmenti a e alokon stafin që bënë monitorimin e MDK-ve në bazë të vlerësimit të rrezikut (siç janë valuta jo euro, volumi i madh i shpenzimeve dhe të hyrave)?

-Mangësi në menaxhimin me personel dhe respektimin e procedurave. Për një menaxhim efikas të proceseve të emërimeve dhe rekrutimit të personelit në MPJ, qoftë brenda apo nëpër MDK duhet respektuar Ligjin për Shërbimin Civil dhe rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. Gjatë testimeve tona kemi gjetur se: MPJ gjatë vitit 2015 kishte angazhuar 20 persona, me kontrata mbi vepër, e që kryesisht ishin angazhuar që të ofrojnë shërbime për përgatitjen e dokumentacionit për anëtarësim në organizata ndërkombëtare/ UNESCO. Sipas LSHC afati i lejuar për kontrata mbi vepër është gjashtë muaj. Në katër raste kishte tejkalim të afatit për tre muaj më shumë se afati i përcaktuar ligjor. Menaxhimi në vazhdimësi me ushtrues detyre përtej limiteve ligjore dhe emërimet nëpër MDK në kundërshtim me rregulloren për shërbimin e jashtëm janë sfida që po e përcjellin MPJ nëpër vite. Në nëntë raste pozitat menaxhuese mbaheshin me ushtrues detyre më gjatë se tre muaj dhe në një rast gradimi dhe emërimi për të shërbyer në MDK ishte në kundërshtim me rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. Zyrtari ishte rekrutuar në MPJ në muajin gusht dhe pas dy muajve ishte graduar dhe emëruar për të shërbyer në MDK). Pse menaxhmenti lejon tejkalimin e periudhës së caktuar me ligj për stafin e angazhuar për shërbime të veçanta (kontrata mbi vepër)? A ka ndonjë plan menaxhmenti për të parandaluar menaxhimin me ushtrues detyre dhe pse anashkalohet afati ligjor? Pse emërimet nëpër MDK bëhen në kundërshtim me rregulloren dhe kriteret e vendosura si në rastin e theksuar?

Mangësi në menaxhimin e pasurive. Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si vijon: Pasuria e paprekshme (softuer të ndryshëm) në vlerë prej 128,532€ të projektit “Krijimi dhe vendosja e sistemit të vizave” nuk ishte e regjistruar në SIMFK në mungesë të raportit të pranimit; dhe Inventarizimi i pasurisë nuk ishte i plotë për shkak të mos prezencës së disa zyrtarëve, si dhe mos qasjes në disa zyre. Po ashtu, nuk ishte kryer inventarizimi i pajisjeve të sistemit të vizave të vendosura në pikë-kalimet kufitare dhe në Aeroportin e Prishtinës, si dhe nuk ishin numëruar stoqet që gjendeshin në depo. Disa nga pyetjet lidhur me çështjen. Pse

Pasuria e paprekshme (softuer të ndryshëm) nuk ishin pranuar nga Komisioni i pranimit? Pse nuk janë numëruar stoqet në fund të vitit dhe inventarizimi nuk ishte i plotë?

Synavere Rysha pyeti se pse në raport ekziston e gjetura për shpenzimet e pa aprovuar, si ka ndodhur kjo dhe se çfarë masa janë marrë nga menaxhmenti për ta penguar këtë dukuri? Po ashtu te çështja e mbylljes së avancave, dallimi për mbi 21,000 euro është për shkak të normave të ndryshme të këmbimit, cilat janë veprimet konkrete?

Ali Sadriu theksoi se mungesa e ministrit për disa takime radhazi ka ndikuar edhe në Agjendën e Komisionit, do të doja që në të ardhmen këto komunikime të jenë të harmonizuara mirë me administratën e komisionit.

Hajdar Beqa pyeti se a ka ndonjë plan MPJ që të plotësojë pozitat të cilat i ka duke i mbajtur me pozita të ushtruesit të detyrës, tani e një kohë të gjatë?

Kryetari theksoi se disa herë radhazi KMFP ka kontaktuar me zyrtarët e MPJ për caktimin e takimin, megjithatë asnjëherë nuk kemi marrë përgjigjeje nga zyrtarët e MPJ, po ashtu edhe nga kabineti i ministrit. Po ashtu shqetësuese mbetet fakti se kjo ministri, nga viti 2008, ka probleme me mbylljen e avancave dhe shpenzime të pa aprovuara. Po ashtu shkelja ligjore për mos caktimin e personave me pozita të rregullta, mirëpo mbahen me pozita të ushtrues të detyrave.

Enver Hoxhaj paraqiti në pika të shkurtra arsyetimin nga të gjeturat e paraqitura në raportin e auditimit për PVF-të e audituara për vitin 2015. Po ashtu ministri u përgjigj në të gjitha pyetjet të cilat u ngritën nga deputetët pjesëmarrës në këtë takim. Më konkret ekziston incizimi i mbledhjes së KMFP-së, ku jepen detalet për secilën të gjetur.

Kryetari theksoi se është mirë të kemi një rekomandim për këtë ministri, dhe nga diskutimet e bëra erdhi deri te ky përfundim.

Përfundim

KMFP, vendosi që Ministria e Punëve të Jashtme, të përgatisë planin e veprimit, duke caktuar personat përgjegjës dhe duke caktuar afatet kohore, për të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti i auditimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për vitin 2015, si dhe me raport me shkrim brenda 3 muajve, ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, se deri ku ka arritur me zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike

Kryetari theksoi se në këtë pikë do të diskutojmë për mënyrën e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për dëgjimin publik për shqyrtimin projektligjit, u diskutua gjatë për këtë pikë dhe në fund u vendos që:

Përfundim

KMFP, vendosi që Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, fillimisht të mbahet dëgjim publik më 21.12.2016. Ndërsa amendamenti i Projektligjit nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike të bëhet me një punëtori që do të mbahet në Durrës(Shqipëri) më 19 deri 22 janar 2017. Ku do të ftohen të gjithë deputetët anëtarë të KMFP-së, stafi Mbështetës i KMFP-së, si dhe tre përfaqësues të Kuvendit.

4. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Shoqëria Civile ka organizuar një debat për Integritetin e OSHP-së në orën 13.00, ku ka ftuar të gjithë deputetët e KMFP-së për të marrë pjesë në këtë takim. Me këtë e mbylli takimin.

Takimi përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli